

V E N D I M
Nr. 382, datë 14.7.2000

PËR RRITJEN E NIVELIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Niveli bazë i pagesës së papunësisë bëhet 3 100 lekë në muaj.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga miratimi i këtij vendimi, përballohen nga fondi i miratuar për vitin 2000 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.
 3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta